



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2024:021471

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05625938

**2024:063931**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK**, Departamenti I Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çeshtjen penale ndaj të pandehurit A.B nga Kaçaniku, i akuzuar për shkak të veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr. PP.nr.34/24 të dt.23.02.2024, pas shqyrtimit të Marrëveshjes për pranimin e fajësisë PP.nr.34/24 të dt.22.02.2024 në seancën dëgjimore të mbajtur me dt.04.04.2024 në prezencë të Prokurorit të shtetit, Sadat Topalli dhe të pandehurit me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare, av.D. R., me datë 05.04.2024 mori dhe shpalli, ndërsa me dt.26.04.2024 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

I pandehuri A.B nga Kaçaniku, rr.”... ” pn, I lindur me dt...., nga I ati A... dhe e ëma B..., e gjinisë L..., shqiptar, shtetas I Rep. se Kosovës, I pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, I gjendjes se mesme ekonomike, me nr. personal: ....

### ËSHTË FAJTOR

Sepse nga data e pa përcaktuar e deri më datën 27 Dhjetor 2023, rreh orës 02:00h në shtëpinë e tij në rrugën “Mejdi Dalloshi”, në Kaçanik, i pandehuri në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm për armët të Republikës së Kosovës Nr.05/L-022, pa autorizim ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar armën e llojit “M-57”, kalibër 7.62 mm, me numër serik ..., një karikator të zbrazët, (3) tre copë fishekë dhe një gëzhjojë të kalibrit të njëjtë, të cilat natën kritike i janë sekuestruar nga ana e policies.

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të nenit 2,38 KPRK-së, nenit 230 par.15,17,18 dhe 20 të KPP-së, sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë PP: nr. 34/24 të dt. 22.02.2024, të pandehurin A. B. , e

## **G J Y K O N**

Me dënim me gjobë në shumë prej 500.00 € ( pesëqind euro).

I pandehuri është i obliguar që dënimin me gjobë t’u paguajë brenda afatit prej 30 ditësh, por jo me gjatë se dy muaj pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe ate në dy këste.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën , gjykata do t’u zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumen prej 20 € për çdo ditë burgu.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë pranë kësaj gjykate shumën prej 20,00€, si dhe taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit në shumën prej 20.00€, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Në pajtim me nenin 366 paragrafi 3 të KPRK-së dhe nenit 276 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 të KPP-së, të pandehurit I konfiskohet arma e llojit “M-57”, kalibër 7.62 mm, me numër serik ..., një karikator i zbrazët, (3) tre copë fishekë dhe një gëzhjojë të kalibrit të njëjtë.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr. 34/24 të datës 23.02.2024 të pandehurin A.B nga Kaçaniku, e ka akuzuar për veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, ndërsa me dt.22.02.2024 ka arritur Marrveshjen për pranimin e fajësise me të pandehurin A.B , me të cilën ka rekomanduar që të pandehurit për veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së. t'i shqiptojë dënim me gjobë në shumë prej 500.00 € ( pesëqind euro).

Ne baze të kësaj Marrveshje , me datë 04.04.2024 gjykata ka caktuar seancën dëgjimore në të cilën kanë prezentuar prokurori I shtetit Sadat Topalli dhe I pandehuri A.B, me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare, av.D. R..

Prokurori I Shtetit në fjalën e tij mbetet në tërësi pranë marrëveshjes për pranimin e fajësisë të dt.22.02.2024, meqë e njëjta është arritur conform dispozitave ligjore të nenit 230 par.1 të KPP-së, me kërkesë të mbrojtësit të të pandehurit dhe me autorizim të kryeprokurorit të shtetit. andaj edhe I kërkon gjykatës që kjo marrëveshje të aprovohet. Prokurori më tutje ka shtuar se, me rastin e negociimit të kësaj marrëveshje janë marrë parasysh të gjitha të drejtat dhe obligimet dhe I kanë rekomanduar gjykatës që të pandehurit A.B, I akuzuar për veprën penale Mbajtje në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, t'I shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 500.00 € ( pesëqind euro) dhe konfiskim të përhershëm të armës.

Mbrojtësi I të pandehurit në fjalën e tij, poashtu e mbështet marrëveshjen për pranimin e fajësisë e arritur në mes të mbrojturit të tij dhe Prokurorisë Themelore në Ferizaj, duke I propozuar gjykatës që të mbrojturit të tij t'i shqiptojë një dënim me gjobë të rekomanduar nga Prokuroria e shtetit ,ndërsa me rastin e shqiptimit të gjobës të ketë parasysh faktin se I mbrojturi I tij është I pa punë dhe jeton në kushte të vështira ekonomike, prandaj edhe I kërkon gjykatës që t'I mundësohet që dënimi me gjobë të paguhet me këste mujore, në një shume e cila nuk do të rrezikonte mirëqenien e tij .

I pandehuri ne fjalën e tij e mbështet në tërësi fjalën e mbrojtësit të tij dhe shton se e ndien veten të penduar për veprimin e tij, të cilin premtan se nuk do t'a përsërisë në të ardhmen dhe duke patur parasysh se është hera e parë që ka kryer një veper penale ,njeherit I kerkon gjykatës që t'a aprovojë marrëveshjen për pranimin e fajësisë të arritur në Prokurorinë Themelore në Ferizaj .

Në bazë të nenit 230 par.17 të KPP-së, gjykata përcakton se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimeve të mjaftuara me mbrojtësin e tij, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat materiale të çështjes penale e cila shqyrtohet e të cilat i përfshinë aktakuza, dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë në nenin 248, të KPP-së. Prandaj gjykata, është e bindur se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara në nenin 230 par.17 të KPP-së.

Prandaj gjykata konform nenit 230 par.20 të KPP-së, pranon Marrëveshjen për pranimin e fajësisë PP. nr. 34/24 të dt.22.02.2024 , dhe te pandehurin e shpall fajtor dhe e gjykon me dënim me dënim me gjobë ne shume prej 500.00€ ( pesëqind euro).

Gjykata është e bindur se, dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është në harmoni me shkallën e përgjegjesisë penale të tij dhe peshën e veprës penale, keshtu që me dënimin e shqiptuar në lartësi si në dispozitiv të aktgjykimit do të arrihet qëllimi i dënimin të paraparë me nenin 38 të KPP-së dhe atë efektin rehabilitues ndaj të pandehurit dhe efektin preventiv ndaj të tjerëve për moskryerjen e një veprimi i cili është i sanksionuar si dhe reagimin e shoqërisë ndaj një veprimi të tillë të ndaluar dhe të ndëshkueshëm me ligj.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 te Ligjit për Kompensimin e Viktimave te Krimit.

Vendimi për konfiskimin e armës së llojit “M-57”, kalibër 7.62 mm, me numër serik BK2806, një karikator i zbrazët, (3) tre copë fishekë dhe një gëzhhojë të kalibrit të njejtë., u mor konfor nenit 366 par.3 të KPRK-së, dhe nenit 276 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 të KPP-së,

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**  
**DEGA KAÇANIK**  
**2024: 063931 datë 26.04.2024**

Sekretarja Juridike,  
Indira Beqa

Gjyqtarja,  
Zajrete Muhaxheri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.